

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70020-25-3241-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Pro Tech Clean SH.P.K.
NUI	811925413
Adresa	Ndue Perlleshi h3 nr 3
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bleona Krasniqi
Adresa elektronike	protechclean.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	22.05.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit

1. Njoftimi për kontrate i datës 18.04.2025

2. Dosja e tenderit e datës 18.04.2025

3. Dosja e tenderit e Amandamentuar 15.05.2025

4. Hapja e tenderit 30.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

1. Parashtrimi i Kërkesës për rishqyrtim 22.05.2025

2. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim 22.05.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ jo-Diskriminimi

Neni 27 Dosja e tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 22.05.2025 ushtrojmë këtë:

ANKESË

Pretendimi 1

Sa i perket aktivitetit te prokurimit me titull: “ **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit**” me nr te prokurimit **70020-25-3241-2-1-1**, vlera e parashikuar në dosjen e tenderit rezulton të jetë dukshëm më e ulët se kostot reale që nevojiten për përmbushjen e kërkesave teknike dhe specifikimeve të detajuara nga autoriteti kontraktues. Kjo krijon një situatë ku operatorët ekonomikë që synojnë të realizojnë shërbimet me cilësi dhe në përputhje me standardet, e kanë të pamundur të ofrojnë një ofertë reale brenda kufijve të

vlerës së përcaktuar.

Pretendimi 2

Gjithashtu tek evidenca 3 kane kerkuar Cit: ‘ ‘ *Operatori Ekonomik (OE) duhet të dëshmojë:*

*Posedimin e pajisjes – vinç, përmes Librezës së automjetit pajisjes, ose Marrëveshjes së **noterizuar** për marrjen e pajisjes me qira. Marrëveshja duhet të përmbajë emrin dhe numrin e këtij projektit. Gjithashtu, duhet të dorëzohet lista e pajisjeve të nevojshme për realizimin*

e punimeve. OE duhet të dëshmoj stafin me diplomë (Noterizuar) Universitare bachelor ose Master, minimumi 3 vite përvojë pune, referenca, CV-ja si dhe Kontrata e punës. Ne analize financiare te mos përfshihet paga per menaxher’’. AK ka bere shkelje të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 26 Grupi i Operatorëve Ekonomik pika 26.16 Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti/personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme

Besojmë se i kemi elaboruar shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe t'i respektojë ne përpikmëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatori Ekonomik :’Pro Tech Clean SH.P.K. në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit** me nr te prokurimit **70020-25-3241-2-1-1**, te iniciuar nga Spitali i Pergjithshem Gjakove.

KORRIGJOHET Dosja e tenderit për procedurën e prokurimit lidhur me aktivitetin: **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit** me nr të prokurimit **70020-25-3241-2-1-1**, të iniciuar nga Spitali i Përgjithshëm Gjakovë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

nuk ka

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*